

VENDIM
Nr.754, datë 8.9.2010

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me institucionet në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, sipas problematikës;

c) shkëmbimin e informacionit, në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;

ç) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve dhe të inspektorëve;

d) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta, në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë;

dh) hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të punëmarrësve.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha